



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 118, Datë 22.07.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.

Në zbatim të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe nenit 100, të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 19 dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, në lidhje me fillimin e procedurave për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a. nëpërmjet shkresës me nr.3053 Prot., datë 07.05.2019, protokolluar në ERE me nr. 330 Prot., datë 09.05.2019, ka percjell për miratim “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.
- Drafti i “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” është hartuar nga shoqëria “OST” sh.a. me asistencën teknike të financuar nga “IFC”.
- Në zbatim të detyrimit që ngarkon neni 98, pika 1 e Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe me qëllim përgatitjen e këtyre rregullave në mënyrë sa më të plotë, OST sh.a. ka percjell për njohje dhe mendim draft-rregullat e tregut shqiptar të balancimit dhe ka zhvilluar takime pune të veçanta me palët e interesuara si, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE, KESH, OSHEE, shoqata e PPE-ve, shoqata e Furnizuesve dhe Tregtarëve të Energjisë Elektrike, ku janë marrë të gjitha mendimet, qëndrimet e palëve mbi këto rregulla dhe është përpiluar drafti final.
- Enti Rregullator i Energjisë në bazë të nenit 98 të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është organi kompetent për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.
- Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike kanë për qëllim të:
 - a. themelojnë menaxhimin me bazë tregu të balancimit të Sistemit Elektroenergjitik, që operohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

- b. përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në tregun e balancimit;
 - c. mundësojnë përgjegjësi të qarta të balancimit për pjesëmarrësit e tregut;
 - d. përshkruajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimit të balancimit,
 - e. krijojnë një mekanizëm për përcaktimin e çmimit të shërbimeve balancuese të prokurara nga OST, si dhe mekanizmin për llogaritjen e çmimit të shlyerjes së disbalancave dhe pagesave financiare të disbalancave për Palët Përgjegjëse të Balancimit; dhe
 - f. çështje të tjera që lidhen me operimin e tregut balancues.
- Gjithashtu Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike kanë si objektiv krijimin e një mekanizmi balancues eficient, transparent dhe jodiskriminues që përcakton përgjegjësitë e balancimit dhe nxit pjesëmarrësit e tregut të kryejnë balancimin, si dhe të ofrojnë shërbime balancuese.
 - Drafti i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, i paraqitur nga OST sh.a. për miratim, është i strukturuar në njëmbëdhjet (11) kapituj dhe tre anekse (3);
 - Kapitulli i parë ka të bëjë me **“Dispozita të përgjithshme”** ku përfshihet: Qëllimi i Rregullave të tregut të balancimit të energjisë elektrike dhe Objektivi i këtyre rregullave.
 - Kapitulli i dytë ka të bëjë me **“Bazën Ligjore”**, ku Ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, përcakton “balancimin” si tërësinë e veprimeve dhe proceseve përmes të cilave OST operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të paracaktuara të qëndrueshmërisë. Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike u hartuan si një dokument plotësues i Rregullave të Tregut sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike, i cili parashikon që Rregullat e Tregut do të përfshijnë balancimin e energjisë elektrike; neni 51 pika 1(b); neni 51 pika 2 (c); neni 98, neni 99 pika (2) dhe neni 3 pika përkufizime (59);
 - Kapitulli i tretë ka të bëjë me **“Miratimin dhe Rishikimin”** ku sipas nenit 98 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ERE me propozimin e OST sh.a. dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton Rregullat e tregut të energjisë elektrike, ku përfshihen rregullat për planifikimin, balancimin, zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe kërkesat për menaxhimin e rezervës. Këto rregulla hyjnë në fuqi ditën e miratimit të tyre nga bordi i ERE-s, duke pasur parasysh nenin 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” dhe nenin 100 pika (3) të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE duhet të marrë një vendim për shfuqizimin e “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike” në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullave të tregut të balancimit të energjisë elektrike. Ndryshimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të balancimit ndjek të njëjtën procedurë si ajo e miratimit të Rregullave të tregut shqiptar të balancimit ku ndryshimi i propozuar paraqitet nga OST sh.a. në ERE për miratim ose iniciohet pas konsultimit me OST sh.a.. Procedura e zgjidhjes së

- mosmarrveshjeve në Rregullat e Tregut Shqipëri të Balancimit ku palët e përfshira në mosmarreveshje do të përpiqen ta zgjidhin atë me mirëkuptim dhe në rast kur mosmarreveshja nuk mund të zgjidhet palët mund të paraqesin mosmarreveshjen e tyre tek ERE në përputhje me Vendimin e bordit të ERE-s, nr.114, datë 08.07.2016;
- Kapitulli i katërt ka të bëjë me **“Qëllimin”** ku përfshihen rolet dhe përgjegjësitë e shoqërsisë OST sh.a..
 - Kapitulli i pestë ka të bëjë me **“Balancimin e Sistemit”**, ku përfshihen specifikimi i masave që duhet të merren nga OST në rastin e disbalancave në sistem; parandalimi i veprimeve balancuese (kompesimi i disbalancave). OST-ja do të lidhë marreveshjet e nevojshme në përputhje me nenin 141 të Kodi të Transmetimi dhe do të implemetojë proceset në përputhje me nenin 158 të tij, masat dhe rendi në të cilin duhet të zbatohen, përgjegjësia e balancimit ku nënkupton detyrimin ligjor mbi palët e lidhura për të dorëzuar skedulimet në lidhje me prodhimin, transmetimin dhe konsumin e energjisë elektrike.
 - Kapitulli i gjashtë ka të bëjë me **“Përkufizime të produktit”**, ku përfshihen katër produkte (FCR, aFRR, Mfrr, RR), balancuese që shërbejnë për të mbajtur frekuencën e rrjetit në nivelin e pranueshëm.
 - Kapitulli i shtatë ka të bëjë me **“Parakualifikimin”**, ku para hyrjes në tregun e balancimit Ofruesi i Shërbimit të Balancimit (OShB) duhet të regjistrohet dhe të marrë certifikatën e parakualifikimi të njërive specifike duke synuar tregtimin e produkteve të veçanta të shërbimit të balancimit.
 - Kapitulli i tetë ka të bëjë me **“Procesin e Angazhimit mbi disponueshmërinë dhe Shpërndarjen”**, ku OST është përgjegjëse për prokurimin e kapacitetit balances në ankandet e angazhimit.
 - Kapitulli i nëntë ka të bëjë me **“Procesin e aktivizimit”**;
 - Kapitulli i dhjetë ka të bëjë me **“Faturimin dhe shlyerjen për OShB”**, ku përmes një platforme të përbashkët ose mjeti tjetër të miratuar, OST do t’i ofrojë OShB pas çdo dite pasuese të punës së operimit, një raport lidhur me të dhënat dhe monitorimin e disponueshmërisë së kapacitetit balancues dhe shpërndarjen e energjisë balancuese në ditën e mëparshme. Brenda dy ditëve pune pas përfundimit të një jave (që përfundon të dielën), OShB mbledh vlerat nga raportet ditore dhe dërgon në departamentin e shlyerjes të OST faturën pro-forma javore të tij për kapacitetin balancues të kontraktuar dhe energjinë balancuese të shpërndarë. Brenda 5 diteve pune pas marrjes së faturës pro-forma, OST do të pranojë ose refuzojë atë. Në përputhje me faturën pro-forma, fatura mund të dërgohet në Departamentin e Faturimit dhe Pagesave vetëm pasi OST të ketë aprovuar faturën pro-forma.
 - Kapitulli i njëmbëdhjetë ka të bëjë me **“Menaxhimin e Kongjestionëve të Brendshme”** ku OST do të ketë detyrimin që ofertat me kohë aktivizimi më të gjatë se 30 minuta, ti përdorë vetëm për menaxhimin e kongjesionit. OST dhe OSSH duhet të deklarojnë zonën e kongjesionit. Nuk lejohen më tej transaksionet brenda zonës

nëse janë arritur limitet e importit të zonës, prandaj OST do të refuzojë nominimet e transaksioneve të tilla.

- Pjesë integrale e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike janë dhe anekset;
 - **Modeli i Marrëveshjes së Ofruesit të Shërbimit të Balancimit(OSHB).** Kjo marrëveshje nënshkruhet ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a. si mbajtës i licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë që organizon tregun balancues për energjinë elektrike dhe Ofruesit të Shërbimit të Balancimit (OSHB), për të siguruar të drejtën për të kryer transaksione në tregun e balancimit të energjisë elektrike, të cilat do të jenë objekt i faturimit dhe pagesave, të drejtat dhe detyrimet e OSHB, referuar pjesmarrjes në Tregun Shqiptar të Balancimit, janë parashikuar në Rregullat e TShB dhe Anekset e këtyre të fundit, si dhe në legjislacionin përkatës në fuqi përfshirë dhe vendimet e ERE-s. Sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshje OSHB pranon me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit duke mbajtur parasysh se, në rast të konfliktit midis Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe kësaj Marrëveshjeje, do të prevalojnë Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit.
 - **Modeli i Marrëveshjes së Palës Përgjegjëse Balancuese(PPB).** Kjo marrëveshje nënshkruhet ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a si mbajtës i licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë që organizon tregun balancues për energjinë elektrike dhe Palës Përgjegjëse Balancuese (PPB). Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, PPB bie dakord të përshtatë aktivitetet e saj me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit. Në rast të konfliktit midis Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe Marrëveshjes, do të prevalojnë Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit.
- Pala Përgjegjëse Balancuese(PPB) pranon që Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit monitorohen dhe miratohen nga ERE dhe se ERE do të ketë të drejtën të imponojë dispozitat e këtyre rregullave mbi PPB, siç parashikohet në to.
- Specifikime të Rregullave të Operimit
 - Ky është një dokument plotësues, i cili i bashkëngjitet Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit. Qëllimi i këtij dokumenti është të shpjegojë të gjithë proceset që zbatohen në Tregun e Balancimit, bazuar në përshkrimin e detajuar të veprimeve të aktivitetit, specifikimeve të aktiviteteve, si dhe kohën e çdo aktiviteti.
- OST thekson në kërkesën e saj se, implementimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit, është parashikuar të kalojë në dy faza. Faza e parë do të jetë miratimi i këtyre rregullave dhe faza e dytë do të jetë faza implementuese (Dry Run). Gjatë kësaj faze OST do të aisstohet nga Asistenca teknike e zgjedhur prej financuesit dhe parashikohet që

problematikat që do evidentohen gjatë kësaj faze do të reflektohen në propozime të mundshme për ndryshime të këtyre Rregullave që janë përcjellë për miratim dhe kërkon që:

1. Miratimin e draft “Rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, me qëllim zbatimin e periudhës së implementimit të tyre për një periudhë testi (Dry Run) pa efekte financiare mbi palët.
 2. Pas përfundimit të kësaj periudhe të implementimit, OST do të paraqesë në ERE për miratim rregullat përfundimtare të tregut të balancimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i materialit vërejmë se:
 - Nuk përcaktohet se sa do të zgjasë koha e periudhës së testit (Dry Run) e implementimit, pa efekte financiare mbi palët.
 - Në kapitullin 3, pika 3.2 “Hyrja në fuqi e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit” përcakton se: “... *ERE duhet të lëshojë një vendim për shfuqizimin e “Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike” në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit*”.
 - Siç parashikohet në këtë draft të depozituar nga OST sh.a., në pikën 3.3.3, flitet për ndryshime të tjera jashtë procesit të përgjithshëm të ndryshimeve, “procesi fillestar i shqyrtimit të zbatimit të rregullave të TSHB”, fillon në varësi të paraqitjes nga OST në ERE të një raporti përmbledhes mbi eksperiencën e fituar nga zbatimi i rregullave. Në këtë pikë nuk shprehet detyruese paraqitja e këtij raporti.
 - Në kapitullin 4 “Qëllimi” pika 4.1.1.7 është lënë bosh pjesa për sa ditë do të pezullohet marrveshja me OshB-në. Ndërkohë në marrveshje në aneks është parashikuar afati 30 ditë.
 - Në kapitullin 5, pika 5.6 “Çmimi i disbalancave”, pika 5.6.1 shprehet se: “*Kostot e prokurimit të kapacitetit rezervë mbarten në tarifë. Çdo rezultat neto për OST nga PPB dhe shlyerja e OShB do të përlllogariten në tarifën e vitit të ardhshëm. Të gjitha kostot e tjera të alokuara për OST për të zhvilluar, operuar dhe mirëmbajtur proceset operative që lidhen me regjistrimin e PPB, ndryshimet, dispozitat e PPB të mundësisë së fundit, shlyerjen e disbalancave, si dhe kosto të ngjashme mbulohen nga tarifa*”. Në lidhje me këtë përcaktim do të diskutohet me Ost dhe palët e interesit të shtohet shprehja “***Këto kosto duhet të jenë të justifikuar dhe argumentuara***”, e cila bazohet tek përcaktimet e “Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017.
 - Në pikën 5.9.1.1 flitet për një PPB (Pala Përgjegjëse për Balancimin), të mundësisë së fundit, por nuk parashikohen kriteret e përcaktimit të tij dhe as cili është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tij. Analogjia me FMF (OSHEE aktualisht) nuk gjen mbështetje në ligj, pasi ligji nuk parashikon PPB të mundësisë së fundit, për më tepër që rolin e FMF mund ta kryejë çdo furnizues që përcaktohet si i tillë dhe jo vetëm OSHEE.

- Në pikën 5.9.3.2 përfshihet opinoin i konsulentit dhe nuk përbën një dispozitë të saktë të rregullave. Gjithashtu analogjia me FMF është e paqartë për përcaktimin e PPB së mundësisë së fundit.
 - Në pikën 5.9.1.5, gërma “b” ndër të tjera thuhet se për koston e PPB të mundësisë së fundit, kostot e këtij roli të përkohëshëm të PPB-së, duhet të mbarten në tarifë pa përcaktuar mënyrën e llogaritjes së këtyre kostove në kushtet e PPB së mundësisë së fundit.
 - Nuk është parashikuar në këto rregulla mënyra e shpërndarjes së përfitimeve financiare të mundshme të OST sh.a. gjatë operimit të këtij tregu tek klientet.
- ERE do të kërkojë nga shoqëria “OST” sh.a. informacion të detajuar në lidhje me të gjitha komentet dhe mendimet e mbledhura nga të gjitha palët e interesit, në fazën e konsultimeve paraprake të kryer nga OST, si dhe shkallën e përfishrjes së tyre në draft-Rregullat e Tregut Shqiptar të balancimit të energjisë elektrike” e përcjellë për miratim.
 - Sa evidentuar, si dhe problematika të tjera që do të dalin gjatë fazës së shqyrtimit dhe dhënies së komenteve, do t’i kërkohet shoqërisë OST sh.a. informacion i detajuar shpjegues, si dhe do të zhvillohen konsultime me publikun për të parë shkallën e përfishrjes së komenteve dhe mendimeve të tyre në rregullat e përcjellë, që paraprijnë miratimin e këtyre Rregullave mjaft të rëndësishme për sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” bashkë me anekset përkatëse, të propozuara nga OST sh.a. me qëllim zbatimin e periudhës së impelmentimit të tyre (Dry Run) pa efekte financiare për një periudhë kohe 6 mujore.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

PETRIT AHMETI